



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
KESHILLI KOMBETAR I UJIT  
Keshilli I Basenit Ujembledhes Mat

**V E N D I M**

**Nr.07 Date 09.11. 2011**

Per

**Shtyrjen e Rinovimit te Lejes Shfrytezimit nr. 10 dt. 09.07.2008 te Inerteve per Subjektin “Delia Group” shpk .**

-Ne mbeshtetje te neneve 8, 14,20 te ligjit nr.8093 dt. 21.03.1996 “Per Rezervat Ujore” dhe te vendimit nr. 3 date 09.01.2003 te Keshillit Kombetar te Ujit “Mbi proçedurat e dhenies dhe te rinovimit te lejeve per shfrytezimin e zhavorreve dhe rerave nga shtreterit e lumenjeve” te ndryshuar me vendim nr 2 dt. 07.06.2007, AUB Mat perveç sqarimeve per kete subjekt lexoi edhe V.K.K.Ujit nr.01 dt 13.01.2010 2010 “**per ndalimin e dhenies se lejeve te reja per shfrytezim te inerteve**”, ku mbas diskutimeve kryesisht te mbeshtetura ne materialin e Drejtorise Teknike MMPAUjrave Tirane mbi mungesen e dokumentacionit ne dosje,**Keshilli i Basenit Ujembledhes Mat,**

**V e n d o s i :**

1.Shtyrjen e Rinovimit te lejes per shfrytezim inertesh ne shtratin e lumit Mat .**Subjekti “DeliaGroup”** sh.p.k me Siperfaqe shfrytezimi **S=0.26 km2, me** kordinata si me poshte:

Pikat	x	y
1.	44 00 992	46 29 407
2.	44 01 400	46 29 375
3.	44 01 275	46 29 200
4.	44 00 595	46 29 120
5.	44 01 450	46 29 040
6.	44 00 992	46 29 261
7.	43 87 000	46 16 000
8.	43 87 000	46 16 937
9.	43 87 250	46 16 875
10.	43 87 440	46 15 900

2. Volumi i parashikuar per shfrytezim  $v=46.000$  m3/vit mbas rinovimit te lejes.

3. Te miratohet Plani Reabilitimit tek ARM si dhe te reflektohen ne studim kushtet per reabilitim te karrieres, reduktimin e volumit te shfrytezimit te inerteve, reperizimin si dhe shfrytezimin ne feta duke filluar nga aksi i lumit sipas vendimit te KBU Mat nr.01dt.31.05.2011, mbjellja e pemeve, reabilitimi i karrieres etjere.

4. Mosplotesimi i kushteve te mesiperme ka per pasoje heqjen e lejes se shfrytezimit. Ne mbledhjen me te afert do te gjykohet per plotesimin e kushteve ne mbledhjen e KBU Mat i cili do te vendose per miratimin apo heqjen e Lejes Shfrytezimit.

5. Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

PERGJEGJESI I A.U.B. MAT  
Pashk NDOCI

KRYETARI I K.B.U. MAT  
Pal DAJCI